

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“VACATION COMPANY LIMITED” SHPK**

Sot, më datë 01.09.2021, në Tiranë, personat me të dhënat si më poshtë:

**Z. K M Shafiqul Islam**, shtetas bangladeshian i datëlindjes 15.06.1985, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. EA0510618,

**Z. Abdullah Rahman**, shtetas bangladeshian i datëlindjes 05.02.1997, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. BX0105353,

Dhe

**Z. Musab Ahmad Husny Abo Alsoud**, shtetas jordanез i datëlindjes 28.07.1980, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. P069190,

Duke vepruar në cilësinë e Ortakëve Themelues, vendosën të themelojnë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "Vacation Company Limited" shpk dhe vendosën të aprovojnë këtë Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqërisë sipas termave dhe kushteve të mëposhtme:

## KAPITULLI 1

### EMRI I SHOQËRISË – REGJIMI JURIDIK – SELIA – KOHËZGJATJA

#### Neni 1

##### Emri i Shoqërisë

- 1.1. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, është krijuar Shoqëria "Vacation Company Limited" shpk, në vijim referuar si "Shoqëria".
- 1.2. Shoqëria ka logon dhe vulën e vet zyrtare.

#### Neni 2

##### Regjimi Juridik i Shoqërisë

- 2.1. "My Location" shpk do të veprojë si një Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar.
- 2.2. Aktiviteti i saj është i organizuar sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi tregtine dhe legjislacionin civil në Republikën e Shqipërisë.
- 2.3. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mund të ndryshojë regjimin e saj juridik, në përputhje me dispozita ligjore në fuqi dhe dispozitat e Statutit të saj.
- 2.4. Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

#### Neni 3

##### Selia

- 3.1. Shoqëria ka selinë e saj në adresën: Qerekë, Krujë, Nr. Pasurie 229/40, vol. 7, faqe 146, Zonë Kadastrale Nr. 3096.
- 3.2. Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda Shqipërisë dhe/ose jashtë vendit, ose të krijojë shoqëri të tjera me partnerë apo aksionarë pjesëmarrës.

Shafiqul

Awins

Awins

## Neni 4

### Kohëzgjatja

4.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të kufizojnë kohëzgjatjen e aktivitetit me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## KAPITULLI II

### OBJEKTI

#### Neni 5

#### Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë lidhet me:

Aktivitetet në fushën e organizimit dhe drejtimit të strukturave akomoduese, hotel dhe ambiente rekreacioni, menaxhimi dhe zhvillimi i turizmit. Agjensi Turistike. Aktivitet catering dhe restorant. Veprimtari e konvertimit të monedhës (EXCHANGE). Veprimtari të tjera të natyrës financiare të lejuara nga ligji. Veprimtari e agjentit për transfertë parash në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jo bankë. Veprimtari e agjentit për shërbimin e pagesave për të tretët në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jo bankar. Import - eksport artukuj te ndryshem. Tregtimin me shumice te te gjithë artikujve. Prodhimin e lendeve te para bujqesore. Tregtimin e ketyre produkteve brenda dhe jashte territorit shqiptar. Importin dhe eksportin e artikujve te ndryshem bujqesore e blegtorale dhe tregtimin e tyre. Prodhimin e energjise elektrike nepermjet shfrytezimit te biomasave. Gjithashtu, shoqeria mund te kryeje cdo lloj aktiviteti tjetër ekonomik, tregtar, financiar qe gjykohet i dobishem dhe i nevojshem per realizimin e objektit te shoqerise, perfshire dhe shitjen e mjeteve te shoqerise sic jane makinerite dhe pajisjet, te japi dhe te marri me qera, te hyje garant, te hipotekoje si dhe te marri pjese ne shoqeri te tjera. Se fundi, shoqeria mund te kryeje cdo operacion tregtar, shitblerje te 2 pasurive te luajtshme apo te paluajtshme, hipotekime, financiare dhe kreditimi, te japi garanci reale dhe personale per te tretet, te bleje, shesi ose marre me qera ndermarrje, dege ndermarrjesh, si dhe te marri interesa dhe te marri pjese ne shoqeri, ente, konsorce te themeluara ose duke themeluar me objekt te njejte ose te afert me qellim te realizoje objektin e shoqerise. Dhe ne pergjithesi, shoqeria mund te kryeje veprimtari te tjera te nevojshme ose te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise. Shoqeria mund te kryeje te gjitha operacionet mbi pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, financiare, tregtare, te lidhi kontrata bilaterale aktive dhe pasive me Institute Krediti te autorizuar nga ligji edhe me firma private, te japi garanci reale per te tretet dhe gjithcka qe eshte e nevojshme per arritjen e qellimit te shoqerise. Shoqeria mund te zhvilloje cdo aktivitet tjetër qe eshte i nevojshem per realizimin e objektit te shoqerise. Per te vetmin qellim te arritjes se objektit te lartpermendur, shoqeria mund te bleje interesa, aksione, pjesemarrje te kapitalit, ne shoqeri te tjera, konsorciume ose kompani te cilat kane objekte te ngjashme apo analoge me te vetin dhe te kryeje te gjitha veprimet komerciale, industriale dhe financiare. Ne vecanti, shoqeria, mund te marre ne pronesi, uzufukt ose me qera, kompani ose dege kompanish qe operojne ne fushen e nje ose me shume prej veprimtarive te mesiperme. Shoqeria mund te jape gjithashtu garanci, garanci mbi kredite dhe depozitat, te lere peng te mira dhe vlere te tundshme, te vendose garanci hipotekore mbi te mirat e patundshme dhe te tundshme te regjistruara dhe te vendose ne pergjithesi cdo garanci te

*shafiq*

*WINS*

*Caro*

mundshme reale dhe personale. Te njejtat garanci mund te vihen dhe ne interes te subjekteve te lidhura me te nga raporte ekonomike ose pjesemarrje, me perjashtim te te tjereve.

Aktivitet prodhimi: Prodhim te ambalazheve plastike, prodhim te ambalazheve te letres, prodhim te ambalazheve te ndryshme me materiale te ricikuleshme, prodhim te qeseve dhe thaseve grumbullues te ndryshme me materiale plastike dhe letre, prodhim qeseve dhe thaseve grumbullues te ndryshme me materiale te ricikuleshme, prodhime te tjera plastike dhe letre me qellime grumbulluese dhe ricikluese, prodhime te tjera me nenprodukte te plastikes dhe letres.

Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

### KAPITULLI III

#### KAPITALI I SHOQËRISË – TRANSFERIMI I KUOTAVE – ZMADHIMI I KAPITALIT

##### Neni 6

##### Kapitali themeltar

6.1. Kapitali i Shoqërisë është në vlerën 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë i ndarë në 3 kuota.

Z. K M Shafiqul Islam zotërues i një kuote që përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë me vlerë 750,000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Z. Abdullah Rahman zotërues i një kuote që përfaqëson 25% (njëzetë e pesë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë me vlerë 375,000 (treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Z. Musab Ahmad Husny Abo Alsoud zotërues i një kuote që përfaqëson 25% (njëzetë e pesë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë me vlerë 375,000 (treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/palujtshme apo të drejta).

Ortaku, i cili pengohet të ushtrojë të drejtat, që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së Shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 (tri) viteve nga çasti i cënimit.

6.2. Përgjegjësia e Ortakut ndaj palëve të treta për detyrime e marra përsipër nga kompania është e kufizuar sipas pjesëmarrjes së ortakut në kapitalin e Shoqërisë.

##### Neni 7

##### Rritja e Kapitalit

7.1. Asambleja e Përgjithshme mund të rrisë kapitalin e shoqërisë, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Shafiqul

Abdullah Rahman

Musab Ahmad Husny Abo Alsoud

7.2. Në rast të një rritje të kapitalit, ortakët kanë të drejtë të nënshkruarit të kuotave nëpërmjet kontributit në natyrë ose në të holla, në proporcion me përqindjen që gëzojnë në kapitalin e shoqërisë.

7.3. Nëse ndonjë nga ortakët refuzon të drejtën e nënshkruarit, kapitali mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, ortakët e tjerë mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për nënshkrimin e kapitalit në proporcion me përqindjen që gëzojnë në kapitalin e shoqërisë.

### **Neni 8**

#### **Zvogëlimi i kapitalit**

8.1. Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Në çdo rast, kapitali nuk mund të reduktohet nën vlerën minimale të përcaktuar me ligj.

8.2. Ortakët përballen me uljen e kapitalit të shoqërisë në proporcion me kuotat e zotëruara nga secili prej tyre në kompani.

### **Neni 9**

#### **Transferimi i kapitalit**

9.1. Pjesët e kapitalit transferohen tek të tretët nëpërmjet vendimit të lëshuar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në përputhje me ligjet në fuqi.

9.2. Ndryshimet duhet të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## **KAPITULLI IV**

### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 10**

#### **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. Ndryshimet e Statutit;
- c. Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d. Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f. Mbikëqyrjen e zbatimin e politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

Shafiqul

WIMS

WIMS

- i. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l. Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- m. Çështje të tjera të parashikuara nga Ligji apo Statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, me anë të një autorizimi, nga një ortak tjetër apo person i tretë.

Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur Shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta, nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## Neni 11

### Administrimi

11.1. Shoqëria drejtohet nga administratorët e saj. Administratorët mund të jenë të çdo kombësie dhe nuk është e nevojshme të jenë rezident në Shqipëri.

11.2. Administratorët e Shoqërisë janë:

- Z. K M Shafiqul Islam i datëlindjes 15.06.1985, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. EA0510618,
- Z. Abdullah Rahman i datëlindjes 05.02.1997, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. BX0105353,
- Z. Musab Ahmad Husny Abo Alsoud i datëlindjes 28.07.1980, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. P069190,

11.3. Administratorët e Shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5-vjeçar me të drejtë ripërtëritje duke filluar nga data e këtij Statuti.


11.4. Administratorët e Shoqërisë emërohen dhe shkarkohen me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.


## Neni 12


### Kompetencat

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a. Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimitarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga ortakët;
- b. Përfaqësojë Shoqërinë tregtare;







- c. Kujdeset për mbajtjen saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- d. Përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara ortakëve të Shoqërisë për miratim;
- e. Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f. Kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g. Raportoje përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme edhe në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim, dhe
- Kur Shoqëria, brenda 2 (dy) viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5% (pesë përqind) të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publik dhe/ose privat, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, bankave të të gjitha niveleve, zyrave të tatim-taksave, autoriteteve doganore dhe autoriteve gjyqësore të të gjitha shkallëve. Administratori angazhon Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e Shoqërisë ose kut të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e Statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Administratori lejohet të delegojë kompetencat tek një person i tretët nëpërmjet një Prokure Noteriale, në rastin kur ai e gjykon të nevojshme për aktivitetin e Shoqërisë.

### Neni 13

#### Përgjegjësitë

Administratorët e Shoqërisë kanë të drejta të plota dhe të barabarta.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme që i sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballur në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit, pasojat përkatëse.

Shafiqul

www.ms

www.ms

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarisë së Shoqërisë në mjedis;
2. Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në Statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
3. Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
4. Të parandalojë dhe mënjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të Shoqërisë;
5. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet e shkaktuara nëse në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a. U kthen ortakëve kontributet;
- b. U paguan ortakëve interesa apo dividend;
- c. U shpërndan aktivet e Shoqërisë;
- d. Lejon që Shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që Shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrime;
- e. Jep kredi;

## KAPITULLI V

### VITI FINANCIAR, DIVIDENTI

#### Neni 14

#### Viti financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Shakir

cvlms

Loes



## Neni 15

### Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

Brenda 6 (gjashtë) muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme miraton bilancin e paraqitur nga administratori. Asambleja e Përgjithshme vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç parashikohet nga ligji.

## Neni 16

### Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë të kontrolleve periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë në kohë Asamblesë për shqyrtim e miratim, bazuar në të drejtën vendimore që Asambleja ka.

## Neni 17

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi ortakëve të shoqërisë sipas përqindjes së përfshirjes në kapitalin themeltar.

## KAPITULLI VI

### SHPËRBËRJA – NDARJA – BASHKIMI – LIKUJDIMI

## Neni 18

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a. Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e tij;
- b. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- c. Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- e. Me vendim të gjykatës.

Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likujduesi/t e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

*Shafiq*

*adms*

*lms*

Nëse Asambleja nuk merr vendim për emërimin e likuidatorit/ëve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidator.

### **Neni 19**

Likuidatori merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidator, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuidatorët ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuidatorët mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuidatorëve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuidatorët u nënshtrohen mbikëqyrjes së ortakëve.

### **Neni 20**

Të drejtat dhe detyrimet e likuidatorit

1. Detyra e likuidatorit është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuidatori mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorë, sipas nenit 194 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", likuidatori vëren se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuidatori detyrohet ta pezullojë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.
4. Likuidatori përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuidatori përgatit gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

### **Neni 21**

#### **Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuidatori njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë në përputhje me seksionin V të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

### **Neni 22**

#### **Bashkimi**

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëri të përthitura, tek një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

*Shafiq*

*adms*

*Leo*

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohet të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

### **Neni 23**

#### **Ndarja**

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008.
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e këtij të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasojë:
  - a. Kalimin tek shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
  - b. Bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet, si aksionare/ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
  - c. Vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e tij nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas seksionit V të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" pa kryerjen e likuidimit.

### **Neni 24**

#### **Shndërrimi**

Shoqëria mund të ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të tij në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

## **KAPITULLI VII**

### **TË NDRYSHME**

#### **Neni 25**

#### **Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Shafiqul

2011

2011

**Neni 26**

**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata.

**ORTAKËT E SHOQËRISË**

**“VACATION LIMITED COMPANY” SHPK**

**K M Shafiqul Islam**

**Abdullah Rahman**

**Musab Ahmad Husny Abo Alsoud**

SHAFIQUL ISLAM

ABDULLAH RAHMAN

Musab AboAlsoud

Shafiqul

awis

